



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONERËT PUBLIKË

Nr. _____ prot.

Tiranë, më 27.5.2021

Lënda: Parashtrimet e Komisionerit Publik në seancën gjyqësore të datës 27.5.2021, për çështjen që i përket ankimit kundër vendimit nr. 231, datë 29.1.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit

Baza ligjore: Neni 179/b, pika 5 e Kushtetutës, neni C, pika 2, neni F, pika 2 e aneksit të Kushtetutës, neni 63 i ligjit nr. 84/2016, “Për rivlerësimin kalimtar të gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë”

Drejtuar: Kolegjit të Posaçëm të Apelit

Të nderuar zonja/zotërinj gjyqtarë,

Komisioneri Publik, në vijim të gjykimit të ankimit të Komisionerit Publik kundër vendimit nr. 231, datë 29.1.2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, që lidhet me subjektin e rivlerësimit Anton Martini, parashtrohet sa vijon:

Trupi gjykues, bazuar në kërkesat e nenit 45 dhe nenit 53, paragrafi 3, i ligjit nr. 84/2016, ka vendosur të çelë hetimin gjyqësor për dy denoncime, si dhe të administrojë akte në funksion të hetimit gjyqësor¹.

Në seancën gjyqësore të datës 11.5.2021, palët konfirmuan marrjen e përgjigjeve të ardhura nga Prokuroria e Përgjithshme, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier dhe Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, të dërguara me kërkesë të Kolegjit, akte këto të administruara në funksion të hetimit gjyqësor.

Në përfundim të kësaj seance gjyqësore, ndër të tjera, trupi gjykues vendosi: (i) Të lejojë marrjen në cilësinë e provës të vendimit gjyqësor, që mban numrin ***, të datës ***.11.2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, bazuar në nenin 45 të ligjit nr. 84/2016; (ii) T’i kërkojë Prokurorisë kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar aktet dhe kopje të faqes së regjistrit, në të cilin është dokumentuar përcjellja e fashikullit hetimor për çështjen me nr. ***

¹ Në lidhje me denoncimin për favorizim të shtetasit ***, ***, të kërkohet informacion dhe kopje e akteve mbi faktin nëse subjekti i rivlerësimit ka pasur ndonjë rol procedural në çështjen penale ndaj këtij shtetas¹. - Sa i përket denoncimit të avokatit ***, ***, në kuadër të fakteve që lidhen me shtetasin ***, ***, të kërkohet informacion nga Prokuroria e Përgjithshme, nëse ka pasur ndonjë kërkesë/ankesë për dërgimin për kompetencë pranë Prokurorisë së Shkallës së Parë Fier, të çështjes që i përket individit ***, ***. - T’i kërkojë Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier informacion dhe kopje të akteve procedurale, në të cilat, çështja që i përket individit ***, ***, me nr. ***/2013, është përcjellë për kompetencë pranë kësaj Prokurorie.

3.2.1 Shkresa nr. ***/** prot., datë ***.5.2021, protokolluar në Kolegjin e Posaçëm të Apelit me nr. ***/** prot., datë ***.5.2021, gjithsej 933 (nëntëqind e tridhjetë e tre) fletë, në lidhje me procedurat e hedhjes së shortit elektronik/manual, pranë kësaj Prokurorie. Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, ndër të tjera, parashtron se: [...] Në pamundësi për të pasur një dokumentacion të plotë të akteve në lidhje me procedurat e hedhjes së shortit manual apo elektronik, po ju dërgojmë një pasqyrim të të gjithë procedurës së hedhjes së shortit dhe ndarjes së dosjeve, për periudhën e kërkuar. Bashkëlidhur fletë të printuara nga e-mail, për problemet në sistemin CAMS (4 fletë); fletë të printuara nga sistemi i shortit elektronik CAMS (48 fletë); dhe procesverbale/shkresa të shortit manual (7 fletë) [...].

3.3 Në këto rrethana, nga informacioni i administruar nga aktet e përcjella, konstatohet se gjatë periudhës ***.11.2017 deri më ***.6.2018, periudhë gjatë së cilës subjekti i rivlerësimit ka ushtruar detyrën e drejtuesit në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Shkodër, janë shpërndarë nëpërmjet shortit të sistemit elektronik CAMS, gjithsej 346 kallëzime, nga 1503 kallëzime të regjistruara gjatë kësaj periudhe.

3.3.1 Për pjesën tjetër të kallëzimeve, prej afro 1100 kallëzime³, nuk rezulton të jetë dokumentuar shortimi i tyre si manualisht, ashtu edhe elektronikisht, nëpërmjet sistemit CAMS.

3.3.2 Ligji nr. 97/2016, “Për organizimin dhe funksionimin e prokurorisë në Republikën e Shqipërisë”, në nenin 42 të tij, përcakton detyrat e drejtuesit në drejtimin e Prokurorisë, ku, midis të tjerash, në gurmën “c” dhe “h” përcakton se: c) organizon shpërndarjen e çështjeve prokurorëve, bazuar në kritere objektive dhe transparente, që përcaktohen nga Prokurori i Përgjithshëm, në përputhje me këtë ligj; h) siguron përdorimin e sistemit të menaxhimit të çështjeve në prokurori.

3.3.3 Udhëzimi nr. 3, datë 29.12.2016, i Prokurorit të Përgjithshëm, “Për shpërndarjen e çështjeve në Prokurori” në kreun II, pika 2, përcakton: [...] se procedura e hedhjes së shortit duhet të jetë e monitorueshme, e dokumentuar dhe transparente, nëpërmjet njoftimit paraprak për zhvillimin e tij [...]. Po ashtu, në Kreun V, Dispozitat e fundit, pika 3, përcakton: “Deri në realizimin teknik dhe ngritjen e infrastrukturës së nevojshme për hedhjen e shortit elektronik nëpërmjet sistemit, procedurat e hedhjes së shortit do të jenë manuale[...]”.

3.3.4 Sa më sipër, konstatohet se nuk janë përmbushur parashikimet ligjore dhe nënligjore në lidhje me përgjegjësinë e drejtuesit të Prokurorisë, mbi organizimin dhe shpërndarjen e çështjeve prokurorëve, bazuar në kritere objektive dhe transparente, si dhe nuk janë dokumentuar procedurat e hedhjes së shortit elektronikisht apo manualisht⁴ për rreth 1100 kallëzime, nga 1503 kallëzime/referime, gjatë periudhës 7-mujore të ushtrimit të funksionit të drejtuesit nga ana e subjektit të rivlerësimit.

³ Referuar akteve të paraqitura nga Prokuroria Shkodër rezultojnë të dokumentuara vetëm 4 procesverbale të shortit manual.

⁴ Në rastet kur infrastruktura teknike (Sistemi elektronik CAMS) ka qenë jashtë funksionit, konkretisht nga data ***.12.2017 deri më ***.2.2018.

4. Në lidhje me denoncimin e avokatit ***, ***, në kuadër të fakteve që lidhen me shtetasin ***, ***, është administruar:

4.1 Shkresa nr. ***/*** prot., datë ***.4.2021, me anë të së cilës Kolegji ka përcjellë shkresën nr. ***/*** prot., datë ***.4.2021, të gjyqtarit kryesues, bashkëlidhur së cilës janë dërguar të njësuara me vulën e sekretarisë së Kolegjit të Posaçëm të Apelimit aktet e vëna në dispozicion nga Prokuroria e Përgjithshme⁵, mbi praktikën që rezulton në zyrën e Arkivit të Prokurorisë së Përgjithshme, për shtetasin *** ***.

4.2 Shkresa nr. ***/***, datë ***.5.2021, me anë të së cilës Kolegji ka përcjellë shkresën nr. ***/*** prot., datë ***.5.2021, të gjyqtarit kryesues, bashkëlidhur së cilës është dërguar komunikimi me Prokurorinë e Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, përkatësisht si vijon:

4.2.1 Shkresa nr. ***/*** prot., datë ***.4.2021, protokolluar në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit me nr. ***/*** prot., datë ***.4.2021, gjithsej 1 (një) fletë, në të cilën Drejtuesi i Prokurorisë Fier shprehet se bashkëlidhur dërgon: 1 (një) kopje të njësuar me origjinalin, të akteve të fashikullit të Procedimit Penal nr. ***/2013 (11 volume), në ngarkim të shtetasit *** ***.

4.2.2 Shkresa nr. ***/*** prot., datë ***.5.2021, e Kolegjit të Posaçëm të Apelimit, gjithsej 2 (dy) fletë, me anë të së cilës Kolegji i ka përcjellë Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, shkresën nr. ***/10 regj., datë ***.5.2021, të gjyqtarit kryesues drejtuar Prokurorisë Fier: *“Kërkesë për informacion”*. Ndër të tjera, gjyqtari kryesues shprehet se: [...] nga Prokuroria Fier janë dërguar kopje të njësuara të akteve të fashikullit të procedimit penal nr. ***/2013, në ngarkim të shtetasit *** ***, gjithsej 11 volume, të cilat nuk janë të numërtuara, por as nuk kanë fletën e inventarit të akteve për secilin volum... Sa më sipër, kërkojmë aktin dhe shkresën nxjerrë nga prokurori Anton Martini dhe drejtuesi i Prokurorisë së Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda, me anë të së cilës është përcjellë dosja pranë Prokurorisë Fier, si dhe vendimin e Gjykatës së Shkallës së Parë për Krimet e Rënda për shpalljen e moskompetencës për çështjen me nr. ***, e vitit 2013 [...].

4.2.3 Shkresa nr. ***/***, prot., datë ***.5.2021, e Prokurorisë pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier, protokolluar në Kolegjin e Posaçëm të Apelimit me nr. ***/*** prot., datë ***.5.2021, gjithsej 1 (një) fletë, në të cilën Drejtuesi i Prokurorisë Fier, ndër të tjera, informon se: [...] *Kopje të fashikullit të procedimit penal me nr. ***, të vitit 2013, janë përcjellë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, mbi bazën e kërkesës së prokurorit që ka përfaqësuar akuzën në gjykim, i cili në funksion të përfaqësimit të çështjes në gjykim, kërkonte të njëjti me këto të fundit. Për sa i përket vendimit... për shpalljen e moskompetencës për çështjen me nr. ***, të vitit 2013, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, nuk e disponon. Ky vendim nuk është pjesë në fashikujt e prokurorit. Nga ana jonë u bënë përpjekje për administrimin e një kopje të këtij vendimi në Gjykatën e Shkallës së Parë Fier, po nga kjo e fundit jemi bërë me dije se dosja ndodhet në Gjykatën e Apelit Vlorë [...].*

4.3 Me shkresën nr. ***/***, datë ***.5.2021, Kolegji ka përcjellë shkresën nr. ***/*** prot., datë ***.5.2021, të gjyqtarit kryesues, bashkëlidhur së cilës është dërguar komunikimi

⁵ Shkresa nr. ***/*** prot., datë ***.4.2021, *“Dërgohet informacion”*.

me Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar⁶, me anë të së cilës përcillet 1 (një) kopje e njësuar me origjinalin të fletës së regjistrit të protokollit, gjithsej 1 (një) fletë, të ish-Prokurorisë së pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Krimeve të Rënda, ku evidentohet përcjellja e disa akteve të procedimit nr. ***/2013, në Gjykatën e Shkallës së Parë për Krime të Rënda Tiranë, me këtë lëndë/përmbajtje: *“Dërgohen prova materiale shitesë për p. p. ***/***/2014, për t’ju bashkëlidhur p. p. ***/***/2014 nga Gjykata e Krimeve të Rënda, datë nisje ***.1.2015, sektori që ndjek zbatimin, arkivuar në dosjen nr. A. M. ***/2013”*.

4.4 Me shkresën nr. ***/**, datë ***.5.2021, Kolegji ka përcjellë shkresën nr. ***/** prot., datë ***.5.2021, të gjyqtarit kryesues, bashkëlidhur së cilës është dërguar komunikimi me:

4.4.1 Prokurorinë e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar⁷, me anë të së cilës përcillet 1 (një) kopje e njësuar e shkresës nr. ***/**, datë ***.4.2015, të ish-Prokurorisë së Krimeve të Rënda, drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, me këtë lëndë/përmbajtje: *“Bashkëlidhur me këtë shkresë po ju dërgojmë kopje të akteve të procedimit penal nr. ***/**, të vitit 2014, në ngarkim të të pandehurit *** ** etj.”*

4.4.2 Prokurorinë e Gjykatës së Shkallës së Parë Fier⁸, me anë të së cilës përcillet 1 (një) kopje e fletës së regjistrit të protokollit për vitin 2015, të Prokurorisë së Shkallës së Parë Fier, ku evidentohen këto të dhëna: *“*** (nr. protokollit), 04.05 (data) ***. *** (prokurori i çështjes), Prokuroria e Krimeve të Rënda (ardhur nga), ***/**, 28.4. (nr. prot. dhe data e shkresës së ardhur), Akte të proc. nr. ***/***/2014, në ngarkim të ***. *** etj. (lënda)”*.

4.5 Me shkresën nr. ***/**, datë ***.5.2021, Kolegji ka përcjellë shkresën nr. ***/** prot., datë ***.5.2021, të gjyqtarit kryesues, bashkëlidhur së cilës është dërguar komunikimi si vijon, me:

4.6 Gjykatën e Apelit Vlorë⁹, me anë të së cilës janë përcjellë kopje të vërtetuara të procesverbalit gjyqësor të seancave të datës 16.3.2015, 30.3.2015, 14.4.2015, 27.4.2015, 15.5.2015, 28.5.2015, 01.6.2015, 09.6.2015, 24.6.2015, 08.7.2015, gjithsej 17 (shtatëmbëdhjetë) fletë.

4.7 Nga informacioni i administruar nga aktet e administruara konstatohet se nga përmbajtja e vendimit nr. ***, datë ***.11.2018, të Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, administruar në cilësinë e provës në seancën e datës 11.5.2021, rezulton se Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, me vendimin **nr. ***/**, datë ***.2.2015**, ka vendosur, ndër të tjera, ndarjen e çështjes penale në ngarkim të të pandehurit ***. ***, shpalljen e moskompetencës lëndore në ngarkim të tij dhe dërgimin e çështjes gjykatës kompetente, Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Fier.

⁶ Shkresa nr. ***/** prot., datë ***.5.2021, protokolluar në Kolegjin e Posaçëm të Apelit me nr. ***/** prot., datë ***.5.2021, gjithsej 1 (një) fletë.

⁷ Shkresa nr. ***/** prot., datë ***.5.2021, protokolluar në Kolegjin e Posaçëm të Apelit me nr. ***/** prot., datë ***.5.2021, gjithsej 1 (një) fletë.

⁸ Shkresa nr. ***/** prot., datë ***.5.2021, protokolluar në Kolegjin e Posaçëm të Apelit me nr. ***/** prot., datë ***.5.2021, gjithsej 1 (një) fletë.

⁹ Shkresa nr. ***/** prot., datë ***.5.2021, protokolluar në Kolegjin e Posaçëm të Apelit me nr. ***/** prot., datë ***.5.2021, gjithsej 1 (një) fletë.

4.7.1 Nga informacioni i përcjellë nga Prokuroria e Posaçme Kundër Korrupsionit dhe Krimit të Organizuar¹⁰, rezulton se *aktet e procedimit penal nr. ***/***, të vitit 2014, në ngarkim të të pandehurit *** ** etj.*, për të cilin, me vendimin e lartpërmendur, ishte shpallur moskompetenca nga Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda, i janë përcjellë Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Fier, përmes shkresës përcjellëse nr. ***/***, datë ***.4.2015, të ish-Prokurorisë së Krimeve të Rënda.

4.7.2 Nga përmbajtja e procesverbaleve të seancave gjyqësore të përcjella nga ana e Gjykatës së Apelit Vlorë, rezulton se në Gjykatën e Shkallës së Parë Fier, çështja ka kaluar për gjykim në datë ***.3.2021. Seancat e radhës të datës 30.3.2015 dhe 14.4.2015 nuk janë zhvilluar dhe janë shtyrë, pasi prokurorja e çështjes ka parashtruar se nuk ishin dërguar aktet nga ana e Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda. Nga data ***.2.2015, kur Gjykata e Shkallës së Parë për Krime të Rënda ka marrë vendim për shpalljen e moskompetencës për gjykimin e çështjes, duke e veçuar atë dhe dërguar për gjykim pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier, rezulton se fashikulli i Prokurorisë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë për Krime të Rënda është dërguar për kompetencë në Prokurorinë pranë Gjykatës së Shkallës së Parë Fier në datën ***.4.2015.

Referuar edhe sa më sipër, Komisioneri Publik vijon t'u qëndrojë kërkimit dhe shkaqeve të ankimit të paraqitur kundër vendimit nr. 231/2020, të Komisionit të Pavarur të Kualifikimit, si dhe parashtrimeve në seancat gjyqësore të zhvilluara, mbështetur në parashikimet e nenit F, pikat 3 dhe 7, të aneksit të Kushtetutës, nenit 66, të ligjit nr. 84/2016.

KOMISIONERI PUBLIK

Florian BALLHYSA

¹⁰ Shkresa nr. ***/*** prot., datë ***.5.2021, protokolluar në Kolegjin e Posaçëm të Apelit me nr. ***/*** prot., datë ***.5.2021, gjithsej 1 (një) fletë.